



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA – REPUBLIC OF KOSOVO
GJYKATA E APELIT PRISHTINË

Numri i lëndës: 2020:128649

Datë: 20.12.2021

Numri i dokumentit: 02532362

Ac.nr. 9808/2021

GJYKATA E APELIT E KOSOVËS, në kolegjin e përbërë prej gjyqtarëve Kujtim Pasulikryetar i kolegjit dhe Nenad Llaziq e Makifete Saliuka, anëtarë të kolegjit, në çështjen juridike kontestimore të paditësit D. L., të cilin e përfaqëson av. B. Sh., nga Prishtina, kundër të paditurve Y. Q., I. Q. dhe K. Q., nga Prishtina, të cilët sipas autorizimit i përfaqëson av. N. S. nga Prishtina, për shkak të pengimit të posedimit, duke vendosur sipas ankesës të autorizuarit të paditësit, av. B. Sh., të ushtruar kundër aktvendimit të Gjykatës Themelore në Prishtinë, C.nr.4405/20 të datës 27.08.2021, në seancën e kolegjit të mbajtur me datë 15.12.2021, mori këtë:

A K T V E N D I M

REFUZOHET si e pa bazuar ankesa e paditësit D. L., nga Prishtina, **VËRTETOHET** aktvendimi i Gjykatës Themelore në Prishtinë, C.nr.4405/2020 të datës 27.08.2021.

A r s y e t i m

Me aktvendimin e goditur nën I të dispozitivit refuzohet si e pabazuar kërkesëpadia e paditësit D. L. nga Prishtina, kundër të paditurit Y. Q. me të cilën ka kërkuar nga gjykata që të vërtetohet se të paditurit Y. Q., I. Q., K. Q., të tre nga Prishtina, e kanë penguar paditësin D. L. në posedimin e fundit faktik të lokalit afarist që gjendet në Prishtinë, në sipërfaqe prej 14.87 m², i regjistruar në njësi Kadastrale 0-71914059-07577-2-379-1, duke e mbyllur me dyer metalike të hekurta dy anët e hapësirës së përbashkët – pasazhit për kalim, duke i pamundësuar paditësit qasjen në lokal dhe e kanë larguar qelqin e dyfishtë nga lokali i paditësit duke e mbyllur atë pjesë me mur me çka ia kanë mbyllur ndriçimin dhe pamjen e lokalit në hapësirën e përbashkët që e ka pasur përmes qelqit të dyfishtë fiks, ashtu që të urdhërohen të paditurit ta vendosin gjendjen e më papashme të posedimit, me zhvendosjen e murit si dhe me largimin e dyerve të hekurta në të dy anët e pasazhit për kalim e veta duke i kthyer paditësit në posedim në tërësi si e pabazuar. Nën

II të dispozitivit refuzohet si e pabazuar kërkesëpadia e paditësit D. L. kundër të paditurve I. Q. dhe K. Q., për shkak të mungesës së legjitimitet real pasiv. Nën III të dispozitivit secila palë i bart shpenzimet e veta procedurale.

Kundër këtij aktvendimi në afatin ligjor ka ushtruar ankesë i autorizuari i paditësit av. B.Sh. nga Prishtina, për shkak të:

-Shkelje thelbësore të dispozitave të procedurës kontestimore ,
-Vërtetim të gabuar dhe jo të plotë të gjendjes faktike dhe
-Zbatim të gabuar të së drejtës materiale, me propozim që Gjykata e Apelit e Kosovës në Prishtinë, ta aprovoj ankesën e paditësit si të bazuar dhe të sjell aktvendim me të cilin do të aprovon si të bazuar kërkesëpadinë e paditësit, ashtu që aktvendimin e goditur ta prish dhe çështjen ta kthej gjykatës së shkallës së parë në rigjykim dhe rivendosje.

Përgjigje në ankesë nuk është parashtruar.

Gjykata e Apelit e Kosovës si gjykatë e shkallës së dytë, duke vepruar në kuptim të nenit 194, e lidhur me nenin 208 të Ligjit të procedurës kontestimore, ka vlerësuar aktvendimin e goditur në kuadër të kufijve të arsyeve të theksuara në ankesë, duke pasur kujdes sipas detyrës zyrtare për shkeljet thelbësore të dispozitave të procedurës kontestimore nga neni 182 par. 2 si dhe për zbatimin e drejtë të së drejtës materiale, dhe gjeti se:

Ankesa është e pabazuar.

Nga shkresat e lëndës rezulton se paditësi ka parashtruar padi me të cilën ka kërkuar që të vërtetohet se të paditurit e kanë penguar paditësin në posedimin e fundit faktik të lokalit afarist që gjendet në Prishtinë, në lagjen Dardania, Ilamella 1, lokali nr. 2, kati përdhes në sipërfaqe prej 14.87 m², i regjistruar si njësi Kadastrale 0-71914059-07577-2-379-1, duke e mbyllur me dyer metalike të hekurta 2 anët e hapësirës së përbashkët – pasazhit për kalim, duke i pamundësuar paditësit qasjen në lokal dhe e kanë larguar qelqin e dyfishtë nga lokali i paditësit duke e mbyllur atë pjesë me mur me çka i kanë mbyllur ndriçimin dhe pamjen e lokalit në hapësirën e përbashkët që e ka pasur përmes qelqit të dyfishtë fikës, ashtu që të urdhërohen të paditurit ta vendosin gjendjen e mëparshme të posedimit, me zhvendosje e murit si dhe me largimin e dyerve të hekurta në të dy anët e pasazhit për kalim, duke i kthyer paditësit në posedim. Ka kërkuar edhe shpenzimet e procedurës kontestimore.

Gjykata e shkallës së parë ka marr aktvendimin më afër të përshkruar si më lart, duke gjetur se në rastin konkret pala paditëse me asnjë provë nuk ka arritur të bëjë të besueshme për gjykatën pretendimet sa i përket kohës së kryerjes së pengimit të bërë nga ana e të paditurve si dhe faktin se a ka qenë në posedimin e fundit faktik të lokalit në kohën kur janë ndërmarr veprimet e pretenduara nga të paditurit. Andaj, gjykata e shkallës së parë pretendimet e paditësit se bazueshmëria e kërkesëpadi së gjen mbështetje ligjore te ekspertiza nga lëmia e ndërtimtarisë dhe ajo e gjeodezisë ka gjetur se është e paqëndrueshme dhe e paargumentuara me fakte ngase në të dy ekspertizat e nxjerra është dhënë mendimi profesional lidhur me gjendjen faktike në të cilën ndodhët lokali në momentin e përpilimit të ekspertizave, kriteret teknike, si dhe ndryshimet që kanë pasur më vonë brenda lokalit që kanë rezultuar me zmadhimin e sipërfaqes së lokalit të cilat nuk kanë qenë në përputhjen me projektin e paraparë banesor, andaj gjykata e shkallës së parë nga ekspertizat në fjalë nuk ka arritur të vërtetoj pretendimet e paditësit lidhur me kohën dhe mënyrën e kryerjes së pengim posedimit nga të paditurit. Gjykata shkallës së parë përveç tjerash me rastin e daljes në vend shikim me datë 18.05.2021, ka vërtetuar faktin se paditësi ishte në

shfrytëzim të qetë të lokalit kontestues dhe i papenguar nga askush, e kjo për faktin se hapja e lokalit është bërë nga motra e paditësit dhe një gjendje e tillë faktike e vërtetuar është në kundërshtim me deklaratimet e dhëna nga i autorizuari i paditësit se pas rastit të pengimit të bërë me dt. 29.12.2009, nga të paditurit të njëjtit e kanë mbyllur lokalin me qelës dhe e kanë në posedim. Përfundimisht gjykata e shkallës së parë e duke u mbështetur në dispozitat e neneve 7.1, 319.1, 322 dhe 480 të LPK-së, e lidhur me nenin 70.1 e 2 , 77 dhe 78 të LMTHJP-së, erdhi në përfundim se kërkesëpadia e paditësit është e pabazuar për arsye se paditësi me asnjë provë të vetme nuk e ka argumentuar pengimin e posedimit, e as kohën kur ka ndodhur akti i pengim posedimit si dhe kohën kur paditësi ka kuptuar për pengimin e bërë, për kundër faktit se është evidente që sipërfaqja e lokalit është e zmadhuar si dhe kahu i hapjes së derës ka ndryshuar krahasuar me projektin banesor fillestar. Gjykata në kuptim të nenit 76 të LPK-së, ka refuzuar kërkesëpadinë e paditësit në raport me të paditurit I. Q. dhe K. Q. në mungesë të legjitimitetit real pasiv për të qenë palë në procedurë, pasi që nuk ka mundur ta provoj se të paditurit në fjalë kanë ndërmarr veprimet në drejtim të pengim posedimit. Gjykata e shkallës së parë ka marr për bazë gjatë vendosjes dispozitën e nenit 7 e cila ka të bëjë me barrën e të provuarit e që është në anën e paditësit. Sa i përket shpenzimeve gjykata e shkallës së parë ka vendosur duke u bazuar në nenin 450 dhe 452 të LPK-së.

Gjykata e Apelit e Kosovës, pran një gjendje të këtillë të çështjes, përfundimin e Gjykatës së shkallës së parë në tërësi e pranon, për faktin se nuk ka shkelje thelbësore të dispozitave të procedurës kontestimore nga neni 182 par 2 pika b), g), j), k), dhe m) të LPK-së, në të cilat kjo gjykatë shikon sipas detyrës zyrtare, e as ato në të cilat thirret ankesa nga neni 182 par. 2 pika n) ngase dispozitivi i aktvendimit të goditur nuk ka të meta për shkak të të cilave nuk mund të ekzaminohet, dispozitivi i aktvendimit të goditur është i kuptueshëm dhe nuk është kontradiktor me vetveten ose me arsyet e aktvendimit dhe në të janë treguar arsyet për faktet vendimtare dhe këto arsye janë të qarta dhe nuk janë kontradiktore, e të cilat arsye i pranon edhe kjo gjykatë.

Thëniet ankimore lidhur me vërtetimin e gabuar dhe jo të plotë të gjendjes faktike, nuk qëndrojnë, ngase gjykata e shkallës së parë nga provat administruara dhe të vlerësuara si dhe me daljen në vend shikim së bashku me ekspertin e gjeodezisë dhe të ndërtimtarisë ka përfunduar se në rastin konkret paditësi me asnjë provë nuk ka arritur ta bëjë të besueshme për gjykatën pretendimet sa i përket kohës së kryerjes së pengimit të bërë nga ana e të paditurve si dhe faktin se a ka qenë në posedimin e fundit faktik të lokalit në kohën kur janë ndërmarr veprimet e pretenduara nga të paditurit. Sipas kësaj gjykate nuk janë të bazuara thëniet ankimore dhe pretendimet se bazueshmëria e kërkesëpadiës gjen mbështetje ligjore te ekspertiza nga lëmia e ndërtimtarisë dhe ajo e gjeodezisë ngase në të dy ekspertizat janë dhënë mendime profesionale lidhur me gjendjen faktike në të cilën ndodhet lokali dhe nga këto ekspertiza gjykata e shkallës së parë nuk ka mundur të vërtetoj kohën dhe mënyrën e kryerjes së pengim posedimit nga të paditurit. Njëherit gjykata e shkallës së parë nuk ka mundur as nga deklaratimet e dëshmitarëve dhe atë të Drita Haxhiu, të vërtetoj kohën dhe mënyrën e pengimit ngase e njëjta është dëgjuar në lidhje me kërkesëpadinë fillestare për pengim posedim lidhur me ndërprerjen e punimeve brenda lokalit e jo për pengimin e bërë nga të paditurit me zhvendosjen e murit në pjesën perëndimore të lokalit dhe me mbylljen e pasazhit për kalim e që është objekt i kërkesëpadiës sipas padisë së precizuar, e për çka një vlerësim të tillë e pranon edhe kjo gjykatë. Kjo gjykatë pajtohet me vlerësimin e gjykatës së shkallës së parë se barra e të provuarit është në anën e paditësit e në kuptim të nenit 7.1 dhe 319.1 të LPK-së dhe në këtë drejtim e duke marr për bazë se gjatë daljes në vend shikim të gjykatës paditësi ka qenë në shfrytëzim të qetë të lokalit të kontestues dhe i papenguar nga askush ngase lokali e ka hapur vet motra e paditësit e cila kishte dhe çelësat, prandaj përfundimisht duke qenë se paditësi nuk ka mundur të argumentoj datën dhe mënyrën e pengimit të bërë, atëherë edhe kjo gjykatë vlerëson se pran gjendjes faktike të

vërtetuar drejtë dhe në mënyrë të plotë, gjykata e shkallës së parë me zbatim të drejtë të së drejtës materiale, drejtë ka vendosur kur ka refuzuar kërkesëpadinë e paditësit. Njëherit kjo gjykatë pajtohet me vendimin e gjykatës së shkallës së parë lidhur me refuzimin si të pabazuar të kërkesëpadisë ndaj paditësve I. Q. dhe K. Q. ngase të njëjtit nuk kanë legjitimitet pasiv.

Prandaj, duke marr për bazë se në çështjen sipas padisë për shkak të pengim posedimit, gjykata kufizohet vetëm në konstatimin dhe të provuarit e fakteve të gjendjes së fundit të posedimit dhe të pengimit të bërë, e në këtë rast gjykata e shkallës së parë pa dyshim ka vërtetuar se paditësi nuk ka mundur të provoj kohën e kryerjes së pengim posedimit dhe të mënyrës dhe duke u nisur edhe nga fakti se në kontestet e pengim posedimit përjashtohet mundësia e shqyrtimit lidhur me të drejtën e posedimit, me bazën juridike, ndërjegjeshmërinë ose pandërgjegjeshmërinë e posedimit, andaj pranë vërtetimit të drejtë dhe të plotë të gjendjes faktike, gjykata e shkallës së parë drejtë ka zbatuar dispozitat e procedurës kontestimore dhe të drejtën materiale, prandaj për këto arsye pretendimet ankimore paraqiten si të pabazuara dhe nuk ndikojnë në marrjen e vendimit ndryshe nga ajo të cilën e ka marr gjykata e shkallës së parë.

Prandaj nga të cekurat si më lart, e në kuptim të nenit 209 par.1 pika b) të LPK-së, është vendosur si në dispozitiv të këtij aktvendimi.

GJYKATA E APELIT E KOSOVËS
Ac.nr.9808/2021 të datës 15.12.2021

Kryetar i kolegjit – gjyqtari
Kujtim Pasuli